

ARBEN SHKEMBI

Mban pozicionin e Këshilltarit Ligjor, në Njësinë e Mbështetjes së Komisioneve të Departamentit Ligjor, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga data 25.09.2019 e në vijim.

Është diplomuar “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës si dhe ka përfunduar programin e studimeve Master Niveli i Dytë.

Ka një eksperience të gjatë në administratën publike dhe gjatë karrierës së tij është angazhuar në shumë detyra në cilësinë e juristit si për shembull; hartim projektakesh ligjore dhe nënligjore, projektakesh administrative, përfaqësim në grupe pune ekspertesh, përfaqësim institucional në gjykatë, inspektive, angazhim në veprimtari të fushës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të shoqërisë civile, etj.

Ka ushtruar detyrën e juristit në Institutin e Studimit të Projektimeve Urbanistike, në vijim atë të përgjegjesit të sektorit juridik në Ministrinë Transportit. Eshte konfirmuar si nëpunës civil dhe ka ushtruar detyrën në pozicionin Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritit në Ministrinë e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Për dy mandate i zgjedhur nga Kuvendi ka ushtruar detyrën Komisioner i Avokatit të Popullit. Gjithashtu ka punuar si Inspektor pranë AKEP.

Eshte angazhuar në trajnime të ndryshme të fushës së jurisprudencës për shkak të detyrës zyrtare si dhe ka marrë pjesë në shumë trajnime dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit.